

Konferencë Kombëtare

“Edukimi Financiar”

(21 Maj 2020)

organizuar

nga

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

THIRRJE PËR PUNIME

RRETH KONFERENCËS

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (Autoriteti) ka kënaqësinë të njoftojë organizimin për të tretin vit radhasi të Konferencës Kombëtare **“Edukimi Financiar”**, në datën 21 maj 2020. Ky aktivitet organizohet nga Autoriteti në kuadër të zbatimit të Strategjisë 3-vjeçare “Për rritjen e besimit të konsumatorit dhe investitorit në tregjet nën mbikëqyrje”.

Qëllimi kryesor i konferencës është të sigurojë një qasje akademike dhe profesionale, si dhe të nxisë diskutimin mbi zhvillimet e sotme më të rëndësishme në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit, problemet dhe sfidat e transformimit të këtyre tregjeve dhe rëndësinë e edukimit financiar në zhvillimin e tyre.

Në kuadër të kësaj konference, panelet janë konceptuar të prezantojnë punimet e përzgjedhura si më të mira, të punuar nga studentë dhe akademikë të interesuar të cilët do të përfaqësojnë kështu edhe Universitetin ku studiojnë apo punojnë. Konferenca synon t’u ofrojë pjesëmarrësve një platformë unike për të paraqitur punimet e tyre dhe për të ndarë njohuritë. Ftohen pjesëmarrësit që me kërkimet të tyre të identifikojnë problematika dhe të vijnë me propozime të ndryshme, të cilat mund t’i shërbejnë rregullatorit dhe palëve të interesit për të kontribuar pozitivisht në zhvillimin e tregjeve nën mbikëqyrjen e Autoritetit.

Punimet janë të mirëpritura nga një spektër i gjerë brenda fushave, të cilat mbikëqyren dhe rregullohen nga Autoriteti. Disa tema janë të propozuara dhe listuar më poshtë, por pjesëmarrësit janë të lirë të zgjedhin edhe çështje të tjera, të cilat nuk janë të propozuara, por që kanë në fokus dhe lidhen me tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit.

Punimet e Konferencës do të fokusohen por nuk kufizohen në këto tema/çështje kryesore:

1. Tregu i Sigurimeve

- ✚ Rëndësia e sigurimeve në zhvillimin e ekonomisë;
- ✚ Si ndikojnë sigurimet në zbutjen e rreziqeve me të cilat ekspozohen bizneset ose familjarët;
- ✚ Risigurimi dhe metoda alternative të transferimit të rrezikut nga shoqëritë e sigurimit;
- ✚ Produktet vullnetare, një e mirë luksi apo një e mirë e domosdoshme;
- ✚ Standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira për qeverisjen ndërkufitare dhe mbikëqyrjen e grupit;
- ✚ Dixhitalizimi në tregun e sigurimeve;
- ✚ Roli i ndërmjetësve në sigurime si kontakti i parë me konsumatorët, kërkesat dhe kodi i sjelljes;
- ✚ Sigurimi vullnetar i shëndetit në tregun e sigurimeve;
- ✚ Sigurimet e pronës, kombinimet në paketa të sigurimeve të ndryshme;
- ✚ Sigurimet e inxhinierisë civile, si lloje të veçanta të sigurimeve;

- ✚ Trajtimi i dëmeve në sigurime, vështrim krahasues i praktikave shqiptare dhe atyre të Bashkimit Evropian;
- ✚ Menaxhimi dhe trajtimi i dëmeve për sigurimet e detyrueshme;
- ✚ Menaxhimi dhe trajtimi i dëmeve në sigurimin e shëndetit vullnetar;
- ✚ Metodologjia në përlogaritjen e çmimeve të sigurimit për produkte të ndryshme të sigurimit;
- ✚ Sigurimi i përgjegjësisë;
- ✚ Menaxhimi i rrezikut në sigurime;
- ✚ Sigurimet dhe Rreziku Sistemik.

2. Tregu i Kapitalit dhe i Fondeve të Investimit

- ✚ Edukimi dhe mbrojtja e investitorëve, sfidat kryesore përpara;
- ✚ Transparenca dhe dhënia e informacionit në tregjet financiare;
- ✚ Bursa dhe faktorët që ndikojnë në funksionimin e saj;
- ✚ Fondet e investimeve, një mundësi alternative investimi, krahasimi me produktet tradicionale të kursimit/investimit;
- ✚ Zhvillimi i tregut të kapitaleve në Shqipëri, sfidat dhe masat që duhen marrë për nxitjen e tij;
- ✚ Strategjia e borxhit të Qeverisë, dhe përdorimi i instrumenteve financiare si mënyra më efikase për menaxhimin e tij;
- ✚ Modelet e zhvillimit të tregut sekondar të titujve të Qeverisë, si një mjet efikas për menaxhimin e borxhit publik në vend;
- ✚ Zhvillimi urban dhe sfidat e financimit – përdorimi i instrumenteve të borxhit (obligacionet e bashkisë) si një alternativë moderne zhvillimi;
- ✚ Privatizimi i kompanive shtetërore nëpërmjet kuotimit në Bursë;
- ✚ A është tregu i titujve, një alternativë e paeksploruar për financimin e biznesit;
- ✚ Sektori Bankar si pjesë komplementare e zhvillimit të tregut të kapitaleve në vend;
- ✚ Shërbimet e ndërmjetësimit në industrinë e titujve – brokerimi, nënshkrimi i titujve, ofertat private dhe publike;
- ✚ Biznesi – alternativa e financimit nëpërmjet kredisë bankare, kundrejt financimit nëpërmjet obligacioneve të korporatave apo listimit në bursë;
- ✚ Vlerësimi i rrezikut të emetuesve të titujve një shërbim i munguar në tregun financiar shqiptar;
- ✚ Sfidat e Fondeve të Investimeve dhe Fondeve të Pensioneve për diversifikimin e portofolit të titujve;
- ✚ Iniciativat që duhen ndërmarrë për nxitjen e zhvillimit të fondeve të investimit dhe fondeve të pensione.

3. Tregu i Pensioneve Private Vullnetare

- ✚ Ngjashmëritë midis produkteve të sigurimit të Jetës dhe investimit në fondet private të pensione;

- ✚ Roli i fondeve të pensionit në tregun financiar, si dhe rëndësia e tyre si një investim afatgjatë për përfituesit.

4. Të tjera

- ✚ Roli i autoriteteve rregullatore në nxitjen e zhvillimit të tregjeve financiare;
- ✚ Ndikimi i edukimit financiar të individëve ose bizneseve në nivelin e zhvillimit të tregjeve financiare nën mbikëqyrjen e Autoritetit;
- ✚ Sfida për një edukim financiar cilësor në arsimin parauniversitar;
- ✚ Masat që duhet të marrin institucionet qeverisëse për të kontribuar në rritjen e edukimit financiar të popullatës;
- ✚ Edukimi Financiar dhe përfshirja financiare;
- ✚ Marketingu dhe tregjet financiare, ekuilibri midis nxitjes së blerjes dhe transparencës nga ofruesit e shërbimeve;
- ✚ Rregullimi financiar dhe inovacioni teknologjik;
- ✚ Qeverisja e shoqërisë për tregjet nën mbikëqyrje;
- ✚ Standardet profesionale - ndërthurje e arsimit dhe trajnimit;
- ✚ Roli i shoqatave profesionale në zhvillimin e tregjeve nën mbikëqyrje;
- ✚ Politikat fiskale dhe ndikimi në tregjet nën mbikëqyrje.

DATA TË RËNDËSISHME

30 mars, 2020	Afati i fundit për dërgimin e abstrakteve
6 prill, 2020	Njoftimi për pranimin e abstrakteve
1 maj, 2020	Afati i fundit për dërgimin e punimit të plotë
15 maj, 2020	Njoftimi për punimet e përzgjedhura
18 maj, 2020	Publikimi i programit të detajuar të Konferencës
21 maj, 2020	Zhvillimi i Konferencës “Edukimi Financiar”

UDHËZIME PËR ABSTRAKTIN

Abstrakti i dorëzuar duhet të shkruhet në përputhje me udhëzimet e mëposhtme:

- Të tregojë qartësisht qëllimin e punimit dhe lidhjen e tij me temën e Konferencës dhe me seksionin përkatës, qasjen e përdorur, rezultatet kryesore të kërkimit dhe rëndësinë e tyre, 4-5 fjalë kyçe dhe duhet të jetë rreth 250-300 fjalë.
- Të jetë i paraqitur në formatin microsoft word dhe të tregojë emrin e plotë të autorit/autorëve, përkatësinë institucionale dhe adresën e-mail. Nuk lejohet pjesëmarrja e një autori me më shumë sesa dy punime.

UDHËZIMET PËR SHKRIMIN E PUNIMIT

Komisioni Vlerësues i Konferencës pranon vetëm punime origjinale, të cilat janë produkt i studimit të autorit/autorëve dhe që nuk janë botuar më parë në ndonjë periodik apo publikim tjetër. Punimet të cilat nuk ndjekin udhëzimet e mëposhtme do të skualifikohen nga

Konferenca:

- Punimi duhet të shkruhet në formatin microsoft word, të jetë i strukturuar në tituj dhe në nëntituj për çdo seksion dhe nuk duhet të jetë më i gjatë se 10 faqe. Këtu nuk përfshihet bibliografia në fund të artikullit, por përfshihen shënimet në fund të faqes;
- Punimet duhet të shkruhen në gjuhën shqipe dhe formati i shkrimit të jetë 12-pt, fonti Times New Roman dhe 10-pt për referencat, shtojcat, shënimet në fund të faqes, tabelat dhe figurat, ndërsa radhitja të jetë justified;
- Hapësira ndërmjet rreshtave të jetë njëshe në të gjithë punimin, duke përfshirë titullin, abstraktin, përmbajtjen e dokumentit, referencat, shtojcat, shënimet në fund të faqes, tabelat dhe figurat, të cilat të jenë të përfshira në tekst, të qendëruara dhe të numërtuara.

Abstraktet dhe punimet do të vlerësohen nga Komisioni Vlerësues i Konferencës dhe vetëm punimet e përzgjedhura do të kalojnë në fazën finale. Pjesëmarrësit do të prezantojnë në Konferencë punimet e përzgjedhura nëpërmjet prezantimit verbal me PWP apo prez. Abstrakti dhe punimi duhet të dërgohen me e-mail në adresën: amf@amf.gov.al

Për punimet që do të vlerësohen si më të mira, do të ndahen gjatë konferencës çmime të ndryshme.

REGJISTRIMI

Për studentët që përfaqësojnë universitete të ndryshme, pjesëmarrja është e lirë dhe nuk ka tarifë regjistrimi. Për informacion më të plotë në lidhje me Konferencën Kombëtare “Edukimi Financiar”, lutemi kontaktoni në adresën: amf@amf.gov.al